



LAJME nga FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË
Tiranë


N.17
Maj
2025

Redaksia "ZKM ALBANIA"
Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

unikzkm
unikzkm
www.unizkm.al
pr@fzkm.org

ATY KU FILLON QYTETËRIMI

Duke medituuar...




Një student e pyeti antropologjen Margaret Mead se cilën konsideronte **shenjën e parë të qytetërimit** në një kulturë. Studenti priste që Mead të fliste për grepa peshkimi, enë prej balte apo gurë mulliri. Por nuk qe kështu. Mead tha se shenja e parë e qytetërimit në një kulturë antike ka qenë një kockë femuri e thyer dhe më pas e shëruar.

Ajo shpjegoi se nëse në botën shtazore një kafshë thyen një gjymtyrë, atëherë ngordh sepse nuk mund t'i shpëtojë rrezikut, të shkojë në lumë për të pirë ujë ose të kërkojë ushqim. Në këtë mënyrë shpjegoi antropologjia kthehesh në pre për kafshët grabitqare që sillen rreth teje. Një kockë femuri e thyer, e cila më pas është shëruar është një dëshmi se dikush ka gjetur kohën të qëndrojë me atë që është dëmtuar, i ka fashuar plagën, e ka çuar në një vend të sigurtë dhe e ka ndihmuar të shërohet. Mead tha se të ndihmosh dikë tjetër në vështirësi është pikërisht tregues se aty nis qytetërimi. Ne jemi versioni më i mirë i vetes kur u shërbejmë të tjerëve. Kjo do të thotë të jesh qytetar.

NJË THIRRËJE E FORTË PËR PJESËMARRJE

T'i japim kuptim misionit tonë




Dy ngjarje, njëren që e kaluam dhe tjetrën që e presim nuk kanë të bëjnë thjesht me tema shkencore, teknike apo sipërmarrjeje. Përkundrazi, bëhet fjalë për aktivitete që synojnë të pasurojnë fuqinë tonë krijuese, e cila është fryt i dijes, i dijes për të vepruar, por veçanërisht edhe i dijes për të ekzistuar.

Konferenca e datës **26 maj** kishte karakter historik dhe global, por pa lënë mënjanë dimensionin shpirtëror dhe lokal. Ai ishte event i parë i Qendrës sonë për Kërkimet Infermiste "Montianum", e cila u themelua në këtë dyqindvjetor të lindjes së themeluesit tonë Luigji Monti, i cili ishte infermier dhe i shenjtëruar.

Ngjarja tjetër, "**Festivali i talenteve**" në datat **4-5 qershor** ndjek të njëjtën linjë, por synon gjithashtu të jetë një moment për diskutim dhe festë, për njohuri dhe pjesëmarrje. Bota ka nevojë për talente të cilat janë dhurata të Frymës së Zotit për njerëzimin. Edhe në Kampusin tonë janë të pranishme shprehje të **ndryshme të talenteve**. Por a i njohim ato? Gjej rastin të ftoj studentët, pedagogët dhe bashkëpunëtorët tanë si edhe të gjithë të interesuarit të përjetojnë me ne këto momente rienergjitimi njerëzor dhe shpirtëror.

fratell Ruggero



ETIKA E SHËRBIMIT DHE JO TREGU DUHET TË "DREJTOJË" MJEKËSINË

Një profesion që lind nga një thirrje (që duhet mbështetur)



nga **SILVIO GARATTINI**

Themelues dhe President i Institutit për Kërkime Farmakologjike Mario Negri - Milano

A e kupton vërtetë gjimnazisti, i cili konkuron për t'u pranuar në mjekësi në universitet, se ndjekja e këtij programi studimi është një thirrje për të fituar një profesion apo është një ftesë, një predispozitë, një pasion? Në konceptin e thirrjes ekziston një shpjegim fetar që në një farë mënyre barazon rolin e priftit me atë të mjekut që kujdeset për vuajtjet e pacientit të tij. Ky njeri vë në dispozicion aftësitë profesionale të shoqëruara me kujdesin dhe praninë e tij, duke risjellë në një farë mënyre kuptimin e kujdesit hyjnor. Thirrja e mjekut nuk mund të ndahet nga ajo që ka nevojë pacienti. Kur diskutojmë mbi rolin e mjekut duhet gjithashtu të kujtojmë se roli i tij ka ndryshuar ndjeshëm.

Mjekësia në thelb ka qenë edhe kujdestare. "Kështu më tha mjeku dhe kështu duhet bërë" – por sot ajo është bërë edhe mbrojtëse pasi pacientët kërkojnë informacion në internet dhe shumë shpejt do të kenë edhe Inteligjencën Artificiale. Sot ata edhe diskutojnë me mjekun, shpesh duke kërkuar atë që mendojnë se është më e mira për shëndetin e tyre. Edhe mjekësia ka ndryshuar sepse nuk është më e mundur që një mjek të bëjë gjithçka i vetëm. Puna e tij duhet të integrohet me punën e mjekëve të tjerë sepse bashkëpunimi është bërë thelbësor jo vetëm në spitale, por edhe në terren. Thirrja është një zgjedhje që buron nga një dëshirë e brendshme, duhet të mbështetet, por edhe të çlirohet nga lidhje apo vështirësi. Kjo për fat të keq është shumë e pasigurtë ndonjëherë sepse pranimi në mjekësi nuk bazohet vetëm tek motivimet, tek etika dhe tek aspektet empatike të veprimtarisë mjekësore. Shkolla e mjekësisë nuk shihet si një "seminar" apo një shkollë ku dikush ushtron talentin e tij: në përgjithësi, jemi mësuar që në salla laksionesh dëgjohen në mënyrë pasive pedagogët ndërkohë që nuk ka një edukim më vete për të menduar për pacientin.

Sepse shkolla është edhe për t'u ushtruar në përmirësimin e marrëdhënieve me të tjerët, në njohjen

e sakrificave që do të përballohen, duke l arsdhur në ndihmë të sëmurit.

Shërbimi Shëndetësor Kombëtar duhet të mbështesë thirrjen mjekësore, ndërkohë që në vend të kësaj u ngarkon mjekëve dhe infermierëve një burokraci të bezdisshme gjatë punës, në vend që t'u sigurojë më shumë kohë për të sëmurët dhe për studime. Ekzistojnë edhe probleme të tjera. Për shembull, pagat tepër të ulëta të mjekëve dhe infermierëve bëjnë që mjekët të largohen nga shërbimi publik për të kaluar në sektorin privat ose jashtë vendit ku paguhen më mirë dhe ku është më e lehtë të krijosh dhe mbash një familje. Duhet gjithashtu të merret në konsideratë fakti se sot ka më shumë interes nga mjekët dhe infermierët për ato disiplina mjekësore që nuk kërkojnë punë gjatë natës apo në ditët e festave, siç janë okulistika dhe dermatologjia, duke lënë pas dore kështu anestezinë, mjekësinë intensive ose atë paliative.

Ndoshta ka më pak tendencë për sakrificë dhe më shumë egoizëm. Sa mjekë të rinj janë të gatshëm të heqin dorë nga mbrëmjet me miqtë në mënyrë që të studiojnë me shqetësimin se mos gabojnë në trajtimin e pacientëve të tyre? Është shumë më e lehtë të pranohet informacioni që vjen nga tregu i mjekësisë, të pranohet pjesëmarrja në udhëtime për kongrese dhe kërkime klinike të paguara mirë nga industria farmaceutike ose diagnostike sesa të kërkohej një informacion i pavarur.

Është më e lehtë të përdoren medikamentet sesa të bindet personi të zbatojë parandalimin përmes rregullave të mira të jetesës. Sigurisht që nuk janë rezultat i një thirrjeje dhe nuk përbëjnë një shembull të mirë shumë mjekë që pinë duhan, konsumojnë alkool, janë mbipeshë ose madje dhe obezë. Por, fatmirësisht ka përjashtime! Ka mjekë që ende e ndjejnë thirrjen por janë të pakët. Ata duhet të shtohen dhe kjo varet nga vullneti i atyre që e lejojnë mjekësinë të qeveriset nga tregu dhe jo nga etika e shërbimit.

KU LINDIN VLERAT

Festa e Fondacionit

Çdo fund prilli në Kampusin Universitar ZKM kremtohet festa e **Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë**. Festa mbledh bashkë të gjithë bashkëpunëtorët, miqtë, stafin akademik dhe studentët e UKZKM që shpërblehen me bursa sipas meritës çdo vit. Festa e Fondacionit është një nga ditët e gëzueshme në kalendarin e organizimeve në Kampusin tonë. Këtë vit festa e Fondacionit nisi me Meshën e Shenjtë të drejtuar nga Arqipeshkvi i Tiranë-Durrësit, **Mons. Arjan Dodaj** dhe më pas u vijua për të pranishmit e shumë me fjalën përshëndetëse të Presidentit të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini**, i cili vlerësoi traditën e krijuar për të kremtuar dhe reflektuar si një moment gjithëpërfshirjeje.

Gjatë kremtimeve studentët e Programit të Studimit në Fizioterapi të UKZKM zhvilluan një garë vrapimi në stafetë përreth pistës së quajtur Mbreti Solomon në Kampusin universitar duke krijuar momente të këndshme gare dhe bashkëveprimi mes studentëve. Si gjithmonë ndarja e bursave ishte kulmi i festimeve që pritet me aq interes nga vetë studentët. Një performancë me numra shpejtësie nga studentit italian **Luca Bonazzi** shte pjesë e aktiviteteve të kësaj dite të paharruar.

NJË ÇMIM PËR PAQEN

Çmimi CESPIC për Paqen: angazhim për Ballkanin dhe Europën

Më 15 maj 2025, në Aula Magna të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u bë prezantimi zyrtar i Çmimit për Paqen CESPIC.

Kjo nismë promovohet nga Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë dhe mbahet në koordinim mes Qendrës Evropiane për Studimet e Paqes, Integritit dhe Bashkëpunimit (CESPIC) dhe Observatorit Ballkan-Kaukaz-Transevropë / Qendrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (OBCT/



me një fokus të veçantë në rajonin e Ballkanit. Çmimi do të dorëzohet në nëntor të këtij viti, ndërsa detajet e ceremonisë do të bëhen të ditura gjatë javëve që vijnë.

Në aktivitetin e promovimit morën pjesë **fr. Ruggero Valentini**, President i Fondacionit ZKM, **Prof. Raul Caruso** Drejtor i CESPIC. Në takim që u zhvillua në vigjilje të Samitit të Komunitetit Politik Evropian në Tiranë u dhanë mesazhe dhe përshëndetje me video nga **Dr. Luisa Chiodi**, Drejtore e OBCT/CCI, **Mons. Gjergj Meta** President i Konferencës Ipeshkvnore të Kishës Katolike në Shqipëri, të cilët ndanë reflektime të thella mbi vlerën e dialogut dhe rëndësinë e një angazhimi të vazhdueshëm për ndërtimin e paqes si proces gjithëpërfshirës.

Prezantimi i çmimit e forcoi më tej mesazhin e një angazhimi të përbashkët për një të ardhme të bazuar në paqe dhe bashkëpunim në mbarë Evropën.

CCI). Gjatë ceremonisë u prezantua juria e përbërë nga ekspertë të njohur, e cila do të ketë detyrën për të përzgjedhur fituesit e këtij çmimi të rëndësishëm vjetor.


Çmimi i Paqes u kushtohet individëve dhe organizatave që janë dalluar për përkushtimin e tyre ndaj paqes,

ROLI I GRUAS PËRMES SHKENCËS, ARTIT DHE HISTORISË

Itali- Shqipëri

Në Aula Magna në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në Tiranë u mbajt konferenca ndërkombëtare me temë "Itali-Shqipëri, roli i gruas përmes shkencës, artit, historisë dhe ekonomisë".

Kjo konferencë ndëruniversitare erdhi si vëmendje e posaçme e të deleguarës së Rektorit të UKZKM për planin e barazisë gjinore **Prof. Ersilia Buonomo**.



si pjesë e qënësishme e një shoqërie që përparon. Prof. Ersilia Buonomo gjatë prezantimit të saj tha se kjo konferencë ndërkombëtare i dedikohet të rinjve, të rejave duke sjellë në vëmendje edhe një simbolikë të dekorit të sallës që ishte mbushur me trëndafila të bardhë në kujtim dhe nderim të Papa Françeskut.

Relatorët gjatë konferencës dhanë pikëpamje



Në audiencën dhe panelet moderuese të konferencës dhanë kontributin e tyre deputetja **Mesila Doda**, profesoresha të nderuara të Universitetit Katolik dhe të universiteteve të tjera të vendit.



të ndryshme rreth zhvillimit të shoqërisë tonë ku gjithmonë synohet t'u jepet një vend i merituar grave dhe vajzave që kontribuojnë me përkushtim e pasion në jetën e përditshme duke ushqyer vlerat më të mira njerëzore.

Rektori i UKZKM **Prof. Leonardo Palombi** gjatë mikpritjes tha se në universitetin tonë duam të promovojmë kulturën dhe kulturën e barazisë gjinore

Përmes dëshmive dhe ndërhyrjeve multidisiplinare, konferenca theksoi rëndësinë e vlerësimit të kontributit femëror në çdo fushë të jetës publike dhe profesionale.



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

THE FUTURE BELONGS to those
WHO BELIEVE in the beauty
of THEIR DREAMS

SFIDAT DHE RISITË NË FUSHËN FARMACEUTIKE

Erasmus +

Një urë akademike midis universiteteve

Në kuadër të programit Erasmus Plus (KA171) mobilitet për mësimdhënie, gjatë javës nga 5 deri më 9 maj 2025, **Prof. Assoc. Malvina Hoxha** realizoi një vizitë në Universitetin e Parmës, ku mbajti leksione me studentët e Fakultetit të Farmacisë dhe të Kursit të Kimisë dhe Teknologjisë Farmaceutike. Gjatë vizitës së saj, Prof. Hoxha pati mundësinë të bisedonte me kolegët e Fakultetit, **Prof. Ilaria Zanotti** dhe **Prof. Vigilio Ballabeni**, me të cilët diskutoi rreth mundësive për bashkëpunime akademike dhe shkencore.



Gjatë qëndrimit të saj, Prof. Malvina Hoxha mbajti disa leksione mbi tema thelbësore për formimin e profesionistëve të ardhshëm të fushës. Ndër temat e trajtuara ishin: "Nga provat klinike tek farmakovigjilenca", "Acidet yndyrore esenciale dhe eikozanoidët" dhe "Analiza ekonomike e ndërhyrjeve shëndetësore: Zbatime të Inteligjencës Artificiale". Leksionet e saj u pritën me interes dhe pjesëmarrje të lartë, duke u ofruar studentëve një perspektivë multidisiplinare dhe të përditësuar mbi sfidat dhe inovacionet në fushën farmaceutike dhe të shëndetit publik.

DËSHMI NGA BRUNILDA KALAJ

Erasmus +

Një udhëtim drejt rritjes profesionale përmes programit Erasmus.



Të flasësh pas një eksperience që ke kaluar është sikur t'i rikujtolesh vetes se si filloi e gjitha. Në momentin që aplikova për Erasmus një përzierje ndjenjash dhe pikpyetjesh më mbuloi mendjen dhe zemrën. Dëshira për të njohur kultura të reja dhe eksperiencat në dukje më frymëzonte, por njëkohësisht stepesha nga e panjohura që më priste. M'u deshën shumë pak ditë në vendin pritës që të kuptoja se kisha marrë vendimin e duhur. Duke parë problematikat dhe mundësitë nga një këndvështrim i ri fillova të ndryshoj mënyrën e të menduarit. Kuptova se kisha shumë informacion për të marrë nga çdo kulturë tjetër që ndodhej në një ambient me mua.

Çdo takim dhe bisedë ishin mundësi të reja për të mësuar dhe secili person kishte një histori dhe një këndvështrim të veçantë që mund të ndikonte në zhvillimin tim. Në këtë periudhë kohore, m'u dha mundësia të investohesha më shumë edhe nga ana profesionale pasi mora pjesë në një internship, konferenca të mbajtura nga personalitete të njohura në botën e artit dhe arkitekturës dhe ekspozita që ndihmuan në formimin tim si një arkitekthe e ardhshme. Ky ishte një hap i rëndësishëm për karrierën time, pasi krijova kontakte me profesionistë që mund

të ishin të dobishëm për të ardhmen. Formimi i një rrethi të ri shoqëror dhe vendosja e vetes në një ambient me kultura të ndryshme më bëri të zbuloj pjesë të karakterit tim që nuk i kisha njohur më parë.

Shoqëria luan një rol të madh dhe unë jam falenderuese ndaj çdo personi që kam njohur në periudhën e shkëmbimit dhe që do vazhdojnë të jenë pjesë e jetës sime. Kjo periudhë më ka ndihmuar të rritem si individ dhe të kuptoj se sa e rëndësishme është të mësosh të komunikosh me njerëz nga të gjitha anët e botës. Në momentin që bëhesh pjesë e Erasmus-it nuk ka më kthim pas. Është një eksperiencë që do t'ja rekomandoja çdo studenti, pasi është një hap për të njohur veten dhe një mundësi që hap shumë dyer, por mbi të gjitha horizontin e çdo njeriu. Kjo përvojë më ka mësuar se jeta është një udhëtim i vazhdueshëm dhe çdo përvojë është një mundësi për të rritur vetëdijen për të mësuar dhe për të eksploruar më shumë mundësi.

BASHKËPUNIM, PARTNËRITET DHE PËRFSHIRJE

Erasmus +

Erasmus+ ICM: një urë përfshirjeje mes Sienës dhe Tiranës

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" mikpritri prej 14 deri më 18 prill 2025 kolegen Annarita Boschetti nga Zyra për Shërbimet Mbështetëse të Shkëmbimit Ndërkombëtar dhe Renditjes në Universitetin e Sienës, Itali. Praktika e koleges realizohet në kuadër të programit Erasmus+ ICM (International Credit Mobility), programi i shkëmbimit Erasmus që zhvillohet me vendet partnere dhe në këtë rast falë bashkëpunimit midis universitetit shqiptar dhe atij italian. Ky është shkëmbimi i parë i një anëtari të stafit administrativ të Universitetit të Sienës në universitetin shqiptar.

Përse zgjodhët këtë universitet dhe çfarë do të thotë për ty të jesh e përfshirë në këtë program shkëmbimi?

Pjesëmarrja në këtë program shkëmbimi për mësimdhënie në Universitetin tuaj ka shumë kuptime për mua. Së pari kryhet në kuadër të programit Erasmus ICM dhe në një vend që nuk është pjesë e Bashkimit Evropian. Kjo është një përvojë shumë e rëndësishme për të parë se si partnerët punojnë në të njëjtin sektor me ne. Gjithashtu është hera ime e parë në Shqipëri, një vend i bukur ku me patjetër dua të kthehem.

Si ndiheni në Tiranë dhe si e pritët këtë bashkëpunim?

Tirana është një qytet shumë mikpritës ku ndihem shumë mirë. Bashkëpunimi është një mundësi e rëndësishme rritjeje për mua dhe edhe pse ky nuk është shkëmbimi i parë ndërkombëtar që bëj, por është në kuadër të Erasmus+ ICM. Për më tepër, unë jam një person me dëmtime në shikim dhe me përvojën time profesionale dhe arsimore dua të kontribuoj në një temë që përfaqëson një qëllim të rëndësishëm në të gjithë sektorët. E kam fjalën për përfshirjen. Përfshirja në studim, arsimim dhe punë është një sfidë e vazhdueshme në të cilën çdo përvojë sjell më shumë nxitje për të menduar dhe për të zbatuar praktikën e mira.



Çfarë ju mësoi kjo përvojë?

Pata mundësinë të fitoj njohuri dhe aftësi të reja. Çdo shkëmbim është një pasurim profesional dhe personal. Një mundësi e shkëlqyer për rritje dhe përmirësim.

DËRMATOŞKOPIA PËR MJEKËT E ARDHSHEM

Seminari i dermatoskopisë




Në datën 5 maj në Aula B105 në UKZKM u zhvillua seminari me temë **“Dermatostopia për studentët: pse dhe si të aplikohet”**. Seminari synoi të ofronte një prezantim të rëndësishëm në fushën e dermatologjisë, veçanërisht mbi onkologjinë me qëllim përdorimin praktik në

dermatoskopi si një mjet diagnostikues. Seminari u moderua nën kujdesin e mjekes **dermatologe të Spitalit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” Amarda Cenko** dhe u strukturua posaçërisht për studentët e mjekësisë që dëshirojnë të familjarizohen me gjuhën, konceptet dhe mjetet bazë të dermatologjisë së aplikuar.

Sëmundjet dermatologjike përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të kushteve klinike me të cilat përballen mjekët në praktikë, si në mjediset ambulatorie ashtu edhe ato spitalore. Ato përfshijnë një shumëllojshmëri të gjerë manifestimesh, nga infeksionet tek çrregullimet inflamatore e deri te neoplazitë e lëkurës. Në veçanti, sëmundjet onkologjike të lëkurës – si karcinoma dhe melanoma – marrin vëmendje në rritje për shkak të incidencës dhe ndikimit të tyre në shëndetin publik.

Procesi i kontrollit shfaq vështirësi si në çdo patologji onkologjike, ndaj testet e shqyrtimit paraqesin një zgjidhje preferenciale për parandalimin dytësor. Edhe



në kontekstin e sëmundjeve të kancerit të lëkurës, diagnoza e hershme mund të sjellë ndryshim për sa i përket ecurisë, komplikimeve dhe prognozës së sëmundjes. Megjithatë, ndryshe nga fushat e tjera të onkologjisë, nuk ka teste të standardizuara dhe efektive të shqyrtimit që janë gjerësisht të disponueshme dhe lehtësisht të arritshme për popullatën e përgjithshme.

Dermatoskopia është një teknikë joinvazive që lejon vizualizimin e strukturave të lëkurës që nuk janë të dukshme me sy të lirë, duke rritur saktësinë diagnostike, veçanërisht në njohjen e lezioneve melanocitare dhe jo melanocitare. Gjatë seminarit u prezantuan parimet themelore të dermatoskopisë, duke ilustruar kriteret kryesore diagnostikuese, si simetria, modelet pigmentare dhe karakteristikat strukturore. Gjithashtu u prezantuan shembuj klinikë dhe u diskutuan raste reale, me synim nxitjen e frymës së vëzhgimit dhe interesimit për studime të mëtejshme në fushën dermatologjike.

BIBLIOTEKA, ZEMRA E DIJES

Dita Kombëtare
e Librit

Libri është bashkëudhëtari i dijes, i formimit dhe i zhvillimit të njeriut. Ku më mirë se në një bibliotekë universitare gjen shprehje kjo thënie e për më tepër festimi i një dite kaq të veçantë siç është ajo e Ditës Botërore të librit e të drejtës së autorit.

Janë pikërisht këto dy koncepte që bashkëshoqërojnë të përditshmen e një studenti që krahas zhvillimeve teknologjike, mbetet besnik i librit fizik, i cili duket sikur dita- ditës kërkon të zëvendësohet me atë elektronik.

Në fakt **Biblioteka e Universiteti Katolik "Fr Paolo Ruatti"**, si një bibliotekë hibride iu bën vend të gjithë adhuruesve të librit të çfarëdo forme, mjafton ti duash e ti respektosh të drejtat e tij, sepse S.R.Ranganathan si një nga figurat më të rëndësishme në fushën e bibliotekonomisë, në themel të formimit e organizimit filozofik të një bibliotekë ka vendosur 5 ligje:



- Libri është për tu përdorur
- Çdo lexues ka librin e vet
- Çdo libër ka lexuesin e vet
- Kurseni kohën e lexuesit
- Biblioteka është një organizëm në zhvillim.

Krahas kësaj, Biblioteka ka në posedim edhe bibliotekën elektronike, si dhe ka krijuar qasje për studentët e vet nëpër bibliotekat më të mëdha në botë, me qëllim që studentët të kenë material të bollshëm për studim e hulumtim.

Për t'iu bashkuar kësaj dite e për ta kremtuar atë si një datë shumë simbolike që nderon lindjen dhe vdekjen e shumë shkrimtarëve

të mëdhenj e për të krijuar ura komunikimi midis kohërave e kulturave Biblioteka jonë organizoi një takim të ngrohtë miqësor mbi rëndësinë e leximit, studimit e të respektimit të drejtës së autorit, duke dëshmuar që biblioteka nuk është thjesht një arkivë librash por një qendër kulturore, një akt intim për ta mbajtur gjallë në gji e të zjarrtë dëshirën e bukurinë e leximit , sepse siç thoshte Luis Borges: *"Gjithmonë kam imagjinuar që parajsa do të jetë një lloj biblioteke"* - mbase ka pasur ndër mend një bibliotekë si e jona ku fluksi dhe dinamika e saj është e tillë që falë dëshirës dhe informacionit të vënë në dispozicion transformohet në vendin ku dija jo vetëm lexohet,

por edhe krijohet, shpërndahet dhe përjetohet. Pa hezitim mund të them që biblioteka jonë për çdo student është jo vetëm zemra intelektuale e universitetit si një kultivuese e dijes, por edhe promotorri i zhvillimit të një brezi që projektton ëndërrat, i sheh të konsoliduara ndër breza dhe aspiron në realizimin e tyre në gjurmë të brezave të mëparshëm.

Socializimi në bibliotekë mbetet çelësi i suksesit të një biblioteke ndryshe, ku ndërveprimi përforcon ndjesinë e komunitetit akademik dhe përforcon idenë që në një botë edhe pse digjitale, aty ofrohen përvoja humane- të qenurit bashkë, fizikisht dhe intelektualisht, për një qëllim të përbashkët: Përhapjen e dijes!

ARKITEKTURA ITALIANE E SHEKULLIT XX

Mësimi i Liberas për qytetin bashkëkohor

Universiteti i Firences organizoi gjatë muajit prill konferencën me temë "Adalberto Libera: Architettura, Interni, Città" në të cilin UKZKM u prezantua me Prof. Andia Guga. Konferenca ishte pjesë e ciklit të konferencave me tematikë "Mjeshttrat e arkitekturës italiane të shekullit XX". Në këtë takim morën pjesë disa universitete ku programet e studimit të Arkitekturës janë pjesë e rëndësishme akademike. Relatorët folën për Arkitektin Adalberto Libera si një nga mjeshttrat e arkitekturës racionaliste italiane, puna e të cilit është koherente edhe në ditët tona. Prof. Andia Guga relatoi për Ndërtesën e Zyrës Postare në Aventino, duke shpjeguar përballë audiences veçoritë e stilit të veprës. Ndërtesa e Postës përfaqëson një sintezë të suksesshme ndërmjet funksionit të saj publik, cilësisë arkitekturore dhe vizionit ideor. Sipas prof. Andia Guga kjo është një vepër që dëshmon për pjekurinë profesionale të arkitektit italian Adalberto Libera dhe efektivitetit të bashkëpunimit me Mario De Renzi. Gati një shekull më vonë ndërtesa qëndron si shembull i mirë-projektuar, funksionale dhe e dobishme për njerëzit. Në një epokë ku diskutohet shumë për cilësinë e hapësirave publike, kjo ndërtesë na kujton se projektimi i mirë është gjithmonë një akt i përgjegjësisë civile.

Prof. Andia Guga është pjesë e programit të studimit në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, i cili është ndërtuar sipas direktivave evropiane të formimit akademik dhe profesional dhe është hartuar me vizionin e kompletimit të një figure shumë dimensionale profesionale së bashku me stafin akademik të Universitetit të Firences, bashkëpunor në këto Programe Studimi.



BASHKËPUNIM AKADEMIK

Vizitë në Kosovë

Në kuadër të projektit “Terapia farmakologjike, trajtimi fizioterapeutik dhe përfitimet e rehabilitimit me hidroterapi të fëmijët me paralizë cerebrale infantile”, të financuar nga Agjencia Kombëtare për Kërkime Shkencore dhe Inovacion dhe të realizuar në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e arsimit dhe shkencës, stafi i Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” vizitoi Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë.

Dekani i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Gjakovës, Prof. Dr. Haxhi Kamberi së bashku me Prof. Ass. Arben Boshnjakun mirëpritën Prof. Assoc. Malvina Hoxha, PhD Enkeleda Gjini dhe PhD Emanuela Prendi, duke rritur mundësitë për një nivel bashkëpunimi akademik midis dy institucioneve.

Gjatë vizitës u zhvillua edhe një takim i frytshëm me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Gjakovës, **Prof. Ass. Dr. Ferdi Kamberi** i përqendruar në zgjerimin e bashkëpunimit në qasjen psikologjike për trajtimin e pacientëve me paralizë cerebrale infantile.



Ky shkëmbim idesh dhe përvojash tregon rëndësinë e integritit të metodave multidisiplinare në kujdesin ndaj pacientëve me paralizë cerebrale infantile. Koordinatorët e projektit, **Prof. Assoc. Malvina Hoxha** (Shqipëri) dhe **Prof. Ass. Arben Boshnjaku** (Republika e Kosovës), diskutuan për punën e kryer deri në këtë periudhë dhe planifikuan aktivitetet e rradhës të lidhura me projektin.

ZHVILLIMI DHE SHËRBIMI NDAJ KOMUNITETEVE

Arkitektura

Konferenca mbi Zhvillimin Lokal dhe Qëndrueshmërinë u mbaj si iniciativë e Prof. Sando Danesi, anëtar i Departamentit të Shkencave Teknike në Arkitekturë. Konferenca bashkoi pedagogë nga programe të ndryshme studimi në UKZKM dhe nga Universiteti i Firences, përfaqësues nga Bashkia e Firences, nga Fondacioni Kombëtar Carlo Collodi dhe **Z. Altin Prenga** si drejtues të agroturizmit më të suksesshëm në Shqipëri, siç është “Mrizi i Zanave”.

Në fjalën hapëse Rektori i UKZKM **Prof. Leonardo Palombi** vlerësoi këtë shkëmbim eksperiencash të vyera midis Shqipërisë dhe Italisë, i mbështetur në këtë vlerësim edhe nga **Prof.ssa Andia Guga** pedagoge e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Fokusi i konferencës ishte koncepti i “Qëndrueshmërisë” në plane shumë dimensionale duke filluar nga urbanistika

dhe arkitektura, tek ekonomia, administrimi politik i territorit, agrobiznesi dhe kultura me qëllim zhvillimin lokal të komuniteteve.

Prof. Giuseppe De Luca (DIDA-UNIFI) solli në vëmendje se në mbarëvajtjen e një projekti të ri urban apo të një rikualifikimi të gjerë aktori kyç është njeriu; njeriu si profesionist që ndërton ambientin në të cilin jetojmë, dhe njeriu si aktor hartues dhe administrues i politikave të zhvillimit të territorit.

Ky proces sa i bukur po aq edhe kompleks kalon në hallka të ndryshme, të cilat duhet të implementohen me përgjegjshmëri, profesionalizëm dhe vizion nga i gjithë aparati qeverisës.



Prof. Riccardo Butini (DIDA-UNIFI-UNIKZKM) prezantoi dy projekte të realizuara në Toskanë mbi dy arkitektura të karakterit industrial. Refleктоhej në këto ndërtesa ndjeshmëria që kishte karakterizuar arkitektin në trajtimin e binomit arkitekturë dhe përmbajtje. Ndërtesat ishin në një dialog të vazhdueshëm me ambientin në të cilin ishin realizuar.

Vëllimet interesante, proporcionet arkitektonike dhe përdorimi i materialeve lokale, bënë që këto dy vepra të konsideroheshin plotësisht të qëndrueshme dhe në respekt me natyrën që i rrethon.



Prof. Giovanni Lagioia (UNIKZM-BARI) bëri një prezantim mjaft interesant mbi ekonominë qarkulluese dhe të proceseve industriale që kalojnë materialet në mënyrë që të garantohet ripërdorimi i tyre për një ambient më të qëndrueshëm. Në seksionin e parë Altin Prenga, sipërmarrës i suksesshëm i Agroturizimit "Mrizi i Zanave" solli eksperiencën e tij mbi formimin dhe menaxhimin e këtij aktiviteti familjar. "Unë nuk mund të jem mirë nëse fqinji im nuk është mirë. Prona nuk ka asnjë vlerë në një ambient të varfër dhe të izoluar", tha Altini, duke



shpjeguar kështu filozofinë e tij mbi bazën e të cilës ka ecur për të ndihmuar zhvillimin e komunitetit në të cilin ndodhet.

Prodhime lokale, përfshirja e punëtorisë së zonës dhe përkrahja e turizmit jo masiv, por të shpërndarë në territor janë shtyllat kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm në Fishtë. Konferenca ishte një rast i shkëlqyer për të dëgjuar relatorët nga Toskana.

Kryebashkiaku **Paolo Pomponi** prezantoi qytezën e Montañones, e konsideruar "jashtë botës" e njëkohesisht "në qendër të saj". Peisazhet natyrore dhe arkitektura historike bashkëjtonin më së miri në këtë vend, i cili është pjesë e "borghi piu' belli d'Italia".



Në Collodi (Toskanë) ndodhet një park tematik për fëmijë, i cili është realizuar tërësisht me të



ardhurat që gjeneron fondacioni. Në mbyllje të kësaj konference Prof.ssa Andia Guga bëri një përmbledhje të prezantimeve duke theksuar rëndësinë që këto tematika kanë sidomos për kontekstin shqiptar.

Ajo solli gjithashtu disa eksperiencë në fushën e arkitektures dhe urbanistikës duke shpjeguar sfidat dhe problematikat me të cilat përballen sot profesionistët shqiptarë në aparatet drejtuese për krijimin e habitateve të qëndrueshme. Guga nënvizoi se roli i arkitektit është thelbësor në shoqëri pasi është e vetmja figurë e kompletuar, gjithpërfshirëse, e aftë të ndjekë gjithë proceset, nga projektimi tek vlerësimi ekonomik, deri në realizimin e veprës.

Uzhvillua me sukses takimi i parë i serisë Talks@UNIZKM_2025, i promovuar nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i Universitetit Katolik. I ftuari i veçantë i këtij aktiviteti inaugurues ishte arkitekti dhe profesori i Universitetit të Katanias, Emanuele Fidone, i cili mbajti një ligjëratë me titullin "Shtresëzimet mes së resë dhe ekzistueses". Takimi solli një reflektim të thellë mbi dialogun mes të kaluarës dhe së tashmes në projektimin bashkëkohor arkitektonik.

Gjatë konferencës, Fidone ndau përvoja dhe projekte në të cilat inovacioni ndërthuret me vlerën e kujtesës historike.

Përmes shembujve konkretë, arkitekti tregoi se ndërtimi mbi ekzistuesen nuk është thjesht një sfidë teknike, por edhe kulturore dhe etike. Qasja e tij, e vëmendshme ndaj kontekstit dhe respektuese ndaj gjurmëve të kohës, nxiti një debat të gjallë mes studentëve, pedagogëve dhe profesionistëve të pranishëm.



GJUHËT BASHKOJNË

Sfidat e edukative arsimore në kohët tona



Çdo gjuhë është një kufi që bashkon dhe nuk ndan, kështu e nisi mirëseardhjen e saj **Prof. Natalina Hoti** Drejtoreshë e Qendrës Universitare të Gjuhëve "Zoja e Këshillit të Mirë" pranë UKZKM ndërsa hapi punimet e Kongresit të Dhjetë të DILLE (Agjensisë Italiane të Mësimdhënies dhe Gjuhësisë Arsimore) që u mbaj

për tre ditë në Aula Magna në Kampusin Universitar ZKM në Tiranë. Të ftuar të shumtë dhe akademikë shkëmbyen përvoja, ide, kontribute duke dhënë një shërbim të shkëlqyer në edukimin e brezave të rinj për gjuhën, këtë pasuri të madhe të njerëzimit.



Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini** tha gjatë mirëseardhjes së tij se shembulli ynë, i UKZKM në Shqipëri ka dhënë kaq shumë për studentët shqiptarë dhe italianë, madje duke u ofruar studentëve shqiptarë një diplomë evropiane edhe pse Shqipëria nuk është pjesë e BE-së.

Ky kongres, tha Presidenti Valentini vjen në mënyrë natyrale në këtë organizim për shkak të këtyre lidhjeve, bashkëveprimeve mes Italisë dhe Shqipërisë që njohin vetëm rritje të qëndrueshme.

Me temën **gjuhët, territore dhe kontekste,**



politikat gjuhësore-edukative sot, tha Presidenti i Fondacionit ZKM duhet të vlerësojmë drejt lidhjen që krijohet mes territorit dhe gjuhëve.

Episodi biblik tregoi ai i Kullës së Babelit sjell në vëmendje dhuratën e Zotit që njerëzve në atë kullë u dha gjuhë të ndryshme si mundësi për t'u kuptuar e për të dialoguar. Ndaj gjuhët, sipas fr. Ruggero Valentini duhet të jenë mjet për të promovuar dhe



mbrojtur komunikimin, dialogun. Rektori i UKZKM **Prof. Leonardo Palombi** në një lidhje virtuale përshëndeti përfaqësuesit e Ambasadës

Italiane në këtë takim dhe miqtë e shumtë duke sjellë në vëmendje momentin historik kur zhvillohet ky takim me themel gjuhësor. Jetojmë në një botë dinamike, tha Rektori ku mijëra njerëz ende nuk e kanë mundësinë të komunikojnë gjerësisht për shkak të mungesës së teknologjisë së komunikimit, ndaj vëmendja që sjell ky takim për edukimin me politika gjuhësore është mundësi që duhet të



promovohet. "Shumë mendojnë se gjuhët janë pengesë, në fakt jo, sepse duke menduar për diversitetin mes nesh sjellim gjithëpërfshirje dhe mundësi për të gjithë", tha Prof. Leonardo Palombi, duke shtuar se politikat efikase gjuhësore japin më shumë shanse për kulturë, punësim, dhe konkurrencë.

Në takim përshëndeti edhe **Sergio Alias** Sekretar i parë i Ambasadës Italiane në Shqipëri, i cili



përgëzoi UKZKM për këtë organizim që i bashkon të gjithë në Shqipëri, në këtë vend që siç tha Z. Alias gëzon mbështjen e Italisë.

"Kemi kaq shumë lidhje në Shqipëri ku gjuha italiane është gjerësisht e përhapur dhe e folur", tha Alias. Sipas tij gjuha italiane ka qenë një urë që ka krijuar këtë marrëdhënie kaq speciale mes Shqipërisë dhe Italisë që e jetuam edhe në vitet '90 kur shqiptarët erdhën në Itali me një njohje të thellë të italishtes që e kishin mësuar thjesht nga televizioni dhe kjo ishte befasuese.

Kongresi i DILLE-s e ka konfirmuar thirrjen e tij për të qenë një vend i debatit të hapur dhe konstruktiv, ku dallimet gjuhësore shndërrohen në mundësi shkëmbimi, respekti dhe bashkëpunimi, duke kontribuar në ndërtimin e urave kulturore dhe akademike gjithnjë e më të qëndrueshme mes popujve.

LUIGI MONTI SHËMBULLI QË FRYMËZON ME VEPREN E TIJ


Shkencat infermieristike



Zhvillimi i konferencave ndërkombëtare në UKZKM është një nga përfitimet e shumta akademike që studentët marrin duke pasuruar dijet e tyre edhe me kontribute shkencore që vijnë nga lektorë të shumtë evropianë dhe jo vetëm për tema të ndryshme.

E tillë ishte Konferenca e mbajtur më **26 maj 2025**, në përvjetorin e dyqindtë të lindjes së At' Luigji Maria Montit, infermier dhe themelues i Kongregatës Bijtë e Zojës së Papërlyer, në Aula Magna, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Konferenca e ndarë në disa

e infermierisë sot në botë. Gjatë fjalës së mbajtur në sesionin me temë "Infermiera dhe karizma e At'Luigi Maria Monti: histori, besim dhe kujdesi shëndetësor në Italinë e shekullit të nëntëmbëdhjetë" Presidenti i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë **fr. Ruggero Valentini**



P. Giuseppe Pusceddu

Gennaro Rocco

Aldo Genova

iu drejtua studentëve në rradhë të parë që të kuptojnë se çfarë përfaqëson Luigi Monti në kohën kur modeli i tij u bë frymëzim për të tjerët, për shërbimin e palodhur ndaj të pamundurëve dhe njerëzve në nevojë.

Presidenti Ruggero tha se dëshironte të risillte dy tre episode jetësore të Luigi Montit që janë shembull

sesione solli informacion të pasur historik, akademik, shkencor dhe frymëzues nën titullin "Trashëgimia e At'Luigji Maria Montit në infermierinë moderne - Bazat dhe risitë e kujdesit".

Gjatë përshëndetjeve institucionale të Rektorit të UKZKM **Prof. Leonardo Palombi**, **P. Giuseppe Pusceddu** Vicario generale CFIC, **Blerina Duka** Presidente e Urdhrit të Infermierit në Shqipëri, **Anila Godo** Zv. Dekane e Fakultetit të Mjekësisë dhe Kirurgjisë në UKZKM u përgëzuan organizatorët për kontributin që japin në evidentimin e kërkimeve të reja që pasurojnë shërbimin



Fr. Ruggero Valentini, President i FZKM



Prof. Leonardo Palombi, Rektor i UKZKM

për pasionin, fantazinë dhe kreativitetin që i dhanë energjinë dhe vullnetin këtij njeriu, shembulli i të cilit

është model edhe sot, por edhe për kohët e vështira kur jetoi kur mjetet dhe shëndetësia nuk kanë nivelin e standardeve që kanë sot. Luigi Monti, tha fr. Ruggero Valentini, arriti të krijojë në atë kohë një komunitet të njerëzve të përkushtuar që me besimin shpirtëror dhe fetar krijuan komunitetin e infermierëve të këtij shërbimi unik në llojin e tij, duke bashkuar aftësitë dhe përlësine e tyre me dhimbshuri në dobi të komuniteteve nevojtare.

Cili është infermieri sot, pyeti Presidenti Ruggero në sallë, njeriu që ofron një shërbim të gjerë njerëzor dhe shëndetësor për ata që kanë nevojë të caktuara dhe kjo detyrë e bërë me profesionalizëm dhe etikë,



P. Michael Sebastian

Anila Godo

Blerina Duka PhD

tha ai, është një model që duhet të udhëheqë edhe të rinjtë, studentët në UKZKM dhe ne që frymëzohemi nga shembulli i këtij themeluesi të thjeshtë si Luigi Monti. Ndërsa Prof. Gennaro Rocco Drejtor i Qendrës Ndërkombëtare për Kërkimin në Shkencat Infermieristike Montianum tha gjatë relatimit të tij se Luigi Monti frymëzon me modelin e tij.



Shqipëria tha ai përballet me sfida delikate dhe të vështira të shërbimit shëndetësor, vështirësi për të ofruar akses të gjerë dhe është fakt shtoi ai se shqiptarët kanë përbulluar vite të vështira në këtë aspekt sidomos pas viteve '90.

Shembulli i Programit të Studimit të Fizioterapisë që lindi në Shqipëri për herë të parë falë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është shembull i shkëlqyer se



Spitali Katolik "ZKM", Tiranë



Spitali Santo Spirito, Romë



Luca Borghi

Dyanne Affonso

Maddalena de Maria

Alessandro Stievano

Diljana Dushku

Peter Preziosi

çfarë solli ky universitet në Shqipëri, tha Prof. Rocco, ndaj duam të përparojmë me inisiativa duke krijuar mundësi, standarde, kërkime që u shërbejnë brezave që vijnë.

Fushat në të cilat përqëndrohet kërkimi në shkencat infermieristike tha Prof. Rocco janë ato të kujdesit parësor dhe parandalimi, sëmundjet kronike apo sëmundjet e shëndetit mendor që po shtohen gjatë viteve të fundit.

Në konferencë u mbajt edhe sesioni me temë "Eksperiencia dhe strategji për zhvillimin e kërkimit në Shqipëri dhe Ballkan".



Një nga momentet emocionuese në Aula Magna ishte kur Zj. Blerina Duka Presidente e Urdhrit të Infermierit në Shqipëri u dha Certifikatat e Mirënjohjes tre profesorëve tanë PhD Enkeleda Gjini, PhD Emanuela Prendi dhe PhD Florian Spada me motivacionin: "Për punën dhe përkushtimin e treguar në rritjen e nivelit profesional, etik dhe kulturor të profesionistëve të kujdesit shëndetësor si dhe për bashkëpunimin me Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë"

TAKIMET E ARDHSHME



CONVEGNO

MERCATO E OCCUPAZIONE UNA PROSPETTIVA INTERDISCIPLINARE E COMPARATA

📅 **3 giugno 2025**
🕒 **09:00**
📍 **AULA 11-12**
UNIVERSITÀ CATTOLICA
"NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO", TIRANA



Kopjet e librit gjenden
në Bibliotekën "Fratel Paolo Ruatti"
pranë Universitetit Katolik
"Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë.



FESTIVAL dei CARISMI

4-5 GIUGNO 2025

📍 UNIVERSITÀ CATTOLICA NSBC
TIRANA-ALBANIA



IN OCCASIONE
DEL BICENTENARIO
DELLA NASCITA
DEL BEATO LUIGI MONTI

📅 **4** Mercoledì
GIUGNO
2025

🕒 **16:30 - 17:30**
📍 Università Cattolica NSBC
Tirana-Albania

UNA STORIA DA CONDIVIDERE

Introduzione
di frater Ruggero Valentini

PRESENTAZIONE
BOZZETTO

Nuova statua di **LUIGI MONTI**
Incontro con l'artista Julian Muçollari



PRESENTAZIONE
LIBRO

TUTTI IN ARRESTO
Incontro con l'autore Olmo Guagnetti

📅 **5** Giovedì
GIUGNO
2025

📍 Università Cattolica NSBC
Tirana-Albania

STORIE IN DIRETTA 🕒 **18:00**

Uomini e donne si raccontano
**COME I CARISMI
FIORISCONO**

INTRODUCONO
Mons. Arjan Dodaj
Arcivescovo Metropolita, Tirana-Durazzo
e Prof. Salvatore Martinez



CONVIVIALITÀ 🕒 **19:30**
Insieme con panino...

LA MAGIA DELLA SABBIA 🕒 **21:00**

**STEFANIA
BRUNO**
SAND ART

Racconta
La straordinaria
avventura
di Luigi Monti



Si prega di segnalare la presenza: 📧 k.dema@fzkm.org